



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 147, datë 25.11.2021

PËR

MIRATIMIN E PËRDORIMIT KUNDREJT TARIFËS, TË PALESTRAVE TË SHKOLLAVE TË ARSIMIT 9 VJEÇAR DHE TË MESËM PËR ZHVILLIMIN E AKTIVITETEVE SPORTEVE PAS PROGRAMIT MËSIMOR DHE NË DITËT E PUSHIMIT

Në mbështetje të nenit 259 e në vijim të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, nenit 8 pika 2, nenit 9 pika 1/1.1, shkronja “b”, nenit 23, pika 11 dhe 12, nenit 25 pika 2, nenit 54 shkronja “e” dhe nenit 55 pikat 4 dhe 6 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, nenit 28, të ligjit nr. 69/2012 “Për arsimin parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjit nr. 79/2017, “Për sportin”, VKB nr. 89, datë 26.07.2021 “Për një ndryshim në VKB Nr.127, datë 24.12.2020 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Durrësit për vitin 2021” në lidhje me dhënien në përdorim të palestrave të shkollave të arsimit 9 vjeçar dhe të mesme për zhvillimin e aktiviteteve sportive pas programit mësimor dhe në ditët e pushimit”, si dhe sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Arsim, Kulturë, Rini, Sporte dhe Komunitete Fetare, me propozim të Zëvendëskryetares së Bashkisë, e cila kryen funksionet e Kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
VENDOSI:

1. Miratimin e Projektit “Shkollat si Qendër Komunitare”, sipas shtojcës nr. 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.

2. Miratimin e përdorimit kundrejt tarifës të palestrave dhe hapësirave rekreative të shkollave të arsimit 9 vjeçar dhe atij të mesëm për zhvillimin e aktiviteteve sportive pas programit të rregullt mësimor dhe në ditët e pushimit.
3. Përdorimi i palestrave dhe ambjenteve të tjera rekreative sipas pikës 2 të këtij vendimi, bëhet përkundrejt pagesës së tarifës të përcaktuar në vendimin nr. 89, datë 26.07.2021 të Këshillit Bashkiak “Për një ndryshim në VKB Nr.127, datë 24.12.2020 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Durrësit për vitin 2021” në lidhje me dhënien në përdorim të palestrave të shkollave të arsimit 9 vjeçar dhe të mesme për zhvillimin e aktiviteteve sportive pas programit mësimor dhe në ditët e pushimit”.
4. Miratimin e marrëveshjes trepalëshe “Tip” që nënshkruhet ndërmjet Bashkisë Durrës, Drejtorisë së Shkollës dhe personave fizikë/juridikë, që do të rezultojnë fitues pas përfundimit të procesit të konkurrimit, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi dhe që është pjesë përbërëse e tij.
5. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi, Drejtoria e Arsim, Kulturë, Rini, Sporte dhe Komunitete Fetare.

Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar).

KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 26.11.2021



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DURRËS
DREJTORIA E ARSIM, KULTURË, RINI, SPORTE DHE KOMUNITETE FETARE

RELACION

PËR MIRATIMIN E PROJEKTIT “SHKOLLA QENDËR KOMUNITARE” SI DHE PËRDORIMIN KUNDREJT TARIFËS TË PALESTRAVE TË SHKOLLAVE TË ARSIMIT 9 VJEÇAR DHE TË MESËM, PËR ZHVILLIMIN E AKTIVITETEVE SPORTIVE PAS PROGRAMIT MËSIMOR DHE NË DITËT E PUSHIMIT.

PARA KËSHILLIT BASHKIAK

KËTU

Të nderuar këshilltarë!

Në zbatim të ligjit 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit 69/2012, “Për arsimin parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjit 79/2017 “Për Sportin” i ndryshuar, si dhe ligji Nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, Ju paraqesim për shqyrtim dhe miratim zbatimin e projektit “Shkolla Qendër Komunitare”, projekt i cili, nis me shfrytëzimin e ambjenteve sportive të Shkollave 9-vjeçare e të mesme të qytetit të Durrësit, kundrejt tarifës, nga persona fizikë/juridikë të licensuar nga Federata Shqiptare për sportin përkatës. Nëpërmjet këtij projekti, dëshirojmë të nxisim të rinjtë të angazhohen në ushtrimin e sporteve të ndryshme, të nxiten fëmijët që mund të kenë talente në sporte specifike, si dhe formimin e fëmijëve në aspektin fizik dhe mendor. Gjithashtu në kuadër të këtij projekti përmirësohet menaxhimi i ambjenteve sportive në Bashkinë e Durrësit në favor të këtyre objektivave të mësipërme.

Qëllimi kryesor i projektit është nxitja e bashkëpunimit ndërmjet personave fizikë/juridikë të licensuar nga Federatat të sportit përkatës dhe Bashkisë së Durrësit duke krijuar një skemë efektive me qëllim përmirësimin e jetës dhe shëndetit të komunitetit si dhe shfrytëzimin e palestrave dhe ambjenteve sportive pranë shkollave 9-vjeçare dhe të mesme publike. Ky projekt parashikon shtrirjen në të gjithë shkollat 9-vjeçare dhe të mesme publike në territorin administrativ të Bashkisë Durrës. Bashkia Durrës do të shpallë thirrje për aplikime për implementimin e këtij projekti nëpërmjet ndjekjes së të gjithë hapave të cilat detajohen si më poshtë :



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DURRËS
DREJTORIA E ARSIM, KULTURË, RINI, SPORTE DHE KOMUNITETE FETARE

Projekti
“Shkolla Qendër Komunitare”

Informacion i përgjithshëm

Projekti “Shkolla Qendër Komunitare”

Nis me shfrytëzimin, kundrejt tarifës prej 200/lekë ora e ambjenteve sportive të Shkollave 9-vjeçare e të mesme të qytetit të Durrësit nga personat fizikë dhe juridikë, të licensuar nga federatat e sportit përkatës për edukimin dhe angazhimin e të rinjve në disiplinat sportive.

Bashkia Durrës nëpërmjet këtij projekti, dëshiron të nxisë të rinjtë të angazhohen në ushtrimin e sporteve të ndryshme si dhe të spikasë fëmijët që mund të kenë talente në sporte specifike, me fokus, formimin e fëmijëve në aspektin fizik dhe mendor si mjet për të luftuar sedentarizmin dhe për të shmangur çdo formë të shfaqjeve negative të kohës, obezitetin si dhe nxitjen e miqësive ndërmjet të rinjve duke u përfshirë në aktivitete sportive.

Qëllimi kryesor i Projektit

Nxitja e bashkëpunimit ndërmjet personave fizikë/juridik të licensuar nga Federatat e sportit përkatës dhe Bashkisë së Durrësit, duke krijuar një skemë efektive me qëllim përmirësimin e jetës dhe shëndetit të komunitetit si dhe shfrytëzimin e palestrave dhe ambjenteve sportive pranë shkollave 9-vjeçare dhe të mesme publike.

Objektivat Specifike

Promovimi dhe implementimi i sporteve si një mundësi edukimi fizik dhe argëtimi për fëmijët e shkollave të ciklit 9-vjeçar dhe atij të mesëm;

- Ndhimesën në zhvillimin e shëndetit, zhvillimin e cilësive fizike, shprehive motorike e koordinative si dhe në vlerat shoqërore të fëmijëve duke ushtruar një sport;
- Formimin e fëmijëve në aspektin fizik dhe mendor, si mjet për të luftuar sedentarizmin dhe për të shmangur çdo formë të shfaqjeve negative të kohës, obezitetin dhe zhvillimin e miqësive ndërmjet nxënësve duke u përfshirë në aktivitete sportive;
- Mundësimi i përfshirjeve dhe realizimit të garave sportive në dobi të shëndetit dhe zhvillimit të aftësive motorike dhe në shërbim të rritjes së cilësisë;
- Evidentimi i rolit të mësuesit (trajnerit), si ekspert dhe edukator i rëndësishëm për fëmijët;
- Rritja e interesit të fëmijëve ndaj sporteve;
- Personat fizikë/juridikë të licensuar nga Federatat e sportit përkatës duhet të mbështesin integrimin në aktivitete sportive pa pagesë të fëmijëve dhe të rinjve të cilët vijnë nga grupe sociale vulnerabël (fëmijët nga familje në nevojë, jetime, ndihmë ekonomike etj.);
- Personat fizikë/juridikë të licensuar nga Federatat e sportit përkatës angazhohen që dy ditë në javë të ofrojnë aktivitete sportive pa pagesë në shërbim të komunitetit;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DURRËS
DREJTORIA E ARSIM, KULTURË, RINI, SPORTE DHE KOMUNITETE FETARE

- Krijimi i traditës ndaj sporteve dhe përmirësimi i infrastrukturës së nevojshme për këtë qëllim;
- Rritja e interesit të fëmijëve dhe komunitetit ndaj sportit.

Elementet kyç

Aplikantët e pranueshëm



Personat fizikë/juridikë të licensuar nga Federatat e sportit përkatës aplikojnë pranë Bashkisë së Durrësit me anë një Formulari Aplikimi ku shprehin interesin e tyre për të ushtruar aktivitetin e tyre në sportin specifik, në palestrën e shkollës ose ambienteve sportive, pas orëve të mësimin. Këto persona duhet të jenë subjekte të regjistruara sipas parashikimeve të legjislacionit në kuadrin ligjor dhe të paraqesin të gjithë dokumentacionin e nevojshëm që e vërteton këtë (Vendim gjykate, Statut, Akt Themelimi, NIUS, licensë nga Federata Shqiptare për sportin përkatës).

Mbulimi gjeografik

Ky projekt parashikon shtrirjen në të gjithë shkollat 9-vjeçare dhe të mesme publike në territorin administrativ të Bashkisë Durrës.

Udhëzuesi për zbatimin

Hapat paraprake

Kryerja e një fushate fillestare informuese mbi projektin nga ana e Bashkisë Durrës për qëllimin e tij dhe mënyrën e funksionimit. Nëpërmjet thirrjes publike për aplikime që do të bëhet në faqen zyrtare të institucionit, do të njoftohen për palestrat dhe ambientet sportive që vendosen në dispozicion nga ana e bashkisë, kundrejt tarifës së miratuar me VKB nr.89, datë 26.07.2021.

Bashkia Durrës pas thirrjes publike për aplikime do të vijojë më ngritjen e komisionit të vlerësimit i cili do të përzgjedhë bazuar në një sistem pikëzimi të miratuar sipas njw urdhërese të titullarit të institucionit. Të interesuarit do të mund të aplikojnë brenda 3 javëve të para, ndërkohë që java e katërt i rezervohet komisionit të vlerësimit të aplikimeve për përzgjedhjen e fituesit për secilën shkollë. Gjithashtu me urdhër të titullarit të institucionit ngrihet Komisioni i Monitorimit të projektit “Shkolla Qendër Komunitare”, për secilën aplikim. Dëmtimet që i vijnë palestrave dhe ambienteve sportive nga ky projekt, janë në ngarkim të personit fizik/juridik dhe rregullohet sipas marrëveshjes së nënshkruar mes këtij të fundit, Bashkisë Durrës dhe drejtorisë së shkollës 9-vjeçare të mesme.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DURRËS
DREJTORIA E ARSIM, KULTURË, RINI, SPORTE DHE KOMUNITETE FETARE

Rezultatet e pritshme

Promovimi dhe implementimi i sporteve si një mundësi edukimi fizik dhe argëtimi për fëmijët e shkollave të ciklit 9-vjeçar dhe atij të Mesëm;

-Ndihmesën në zhvillimin e shëndetit, zhvillimin e cilësive fizike, shprehive motorike e koordinative si dhe në vlerat shoqërore të fëmijëve duke ushtruar një sport;

-Formimin e fëmijëve në aspektin fizik dhe mendor, si mjet për të luftuar sedentarizmin dhe për të shmangur çdo formë të shfaqjeve negative të kohës, obezitetin dhe nxitjen e miqësive ndërmjet të rinjve duke u përfshirë në aktivitete sportive;

-Mundësimi i përfshirjeve dhe realizimit të garave sportive në dobi të shëndetit dhe zhvillimit të aftësive motorike dhe në shërbim të rritjes së cilësisë;

-Evidentimi i rolit të mësuesit (trajnerit), si ekspert dhe edukator i rëndësishëm për fëmijët;

-Rritja e interesit të fëmijëve ndaj sporteve;

-Rritja e interesit të fëmijëve dhe komunitetit ndaj sportit.

Në kuadër të këtij projekti edhe stafi i shkollave mund të marrë pjesë në fushatat ndërgjegjësuere për një jetë të shëndetshme, kundër obezitetit, për një ushqyerje të shëndetshme dhe për pjesëmarrje në sa më shumë veprimtari sportive.

Për sa më lart, dhe nisur nga impakti pozitiv që mendojmë se ky projekt do të ketë, kërkojmë miratimin tuaj për iniciativën e institucionit të Bashkisë për implementimin e projektit “Shkolla, Qendër Komunitare”.

Në zbatim të VKB 89, datë 26.07.2021 “Për një ndryshim në VKB Nr.127, datë 24.12.2020 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Durrësit për vitin 2021” si dhe në vijim të Projektit “Shkolla Qendër Komunitare” kërkojmë bashkëpunimin tuaj për miratimin e dhënies në përdorim të ambjenteve të palestrave dhe ambjentet sportive të shkollave 9 vjeçare dhe të arsimit të mesëm në Bashkinë Durrës, kundrejt tarifës 200 lekë/ora. Struktura e ngarkuar për mbledhjen e kësaj tarifave do të jetë Bashkia Durrës, të ardhura të cilat do të përdoren për mirëmbajtjen e ambjenteve të shkollës përkatëse, palestra e së cilës do të jepet në përdorim.

Përdorimi i palestrave do të lejohet vetëm pas orarit të mësimit, duke mos penguar funksionimin normal të aktiviteteve sportive të shkollës gjatë orarit mësimor. Në këto ambiente do të ushtrorjnë sportin në disiplinë të ndryshme si nxënësit e shkollës, ashtu dhe fëmijët e moshave të ndryshme të zonës përreth.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DURRËS
DREJTORIA E ARSIM, KULTURË, RINI, SPORTE DHE KOMUNITETE FETARE

Në përfundim të sqarimeve të përmendura në këtë relacion, kërkojmë miratimin tuaj :

1. Për iniciativën e institucionit të Bashkisë për implementimin e projektit “Shkolla, Qendër Komunitare”.
2. Përdorimin kundrejt tarifës të palestrave të shkollave të arsimit 9 vjeçar dhe të mesëm për zhvillimin e aktiviteteve sportive pas programit mësimor dhe në ditët e pushimit si dhe të marrëveshjes tip të bashkëpunimit.

Duke Ju falenderuar për mirëkuptimin Tuaj !

Inspektori i Sporteve
Anastas Xharja

Juriste
Elisabeta Ciko

Drejtore i Drejtorisë AKRSKF
Adrian Gurra



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DURRËS
DREJTORIA ARSIM, KULTURË, RINI
SPORT, KOMUNITETE FETARE
SEKTORI I SPORTEVE

Bashkia Durrës Nr. _____ Prot. Shkolla Nr. _____ Prot. Federata/Shoqata/Klubi Nr. _____ Prot.

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

E lidhur sot më ___/___/2021 midis palëve:

Shkolla 9-vjeçare/e mesme “.....”, me adresë:....., përfaqësuar z/znj., me pozicion.....;

Person Fizik/Juridik “.....”, regjistruar me Vendim Gjykatë/ Nipt nr....., me adresë:....., përfaqësuar nga z/znj. me pozicion.....;

Bashkia Durrës, me adresë: “Lagjia nr. 3, Sheshi “Liria”, Durrës, Shqipëri, përfaqësuar nga Kryetari i bashkisë _____.

Palët bien dakord të lidhin këtë marrëveshje sipas kushteve në vijim:



Neni 1 Objekti

Objekti i marrëveshjes është bashkëpunimi midis palëve me qëllim realizimin e projektit “Shkolla Qendër Komunitare” në shkollat e arsimit 9-vjeçar dhe të mesëm.

Projekti konsiston në dhënie në përdorim kundrejt tarifës 200 lekë/ora , të ambienteve sportive të shkollave për të zhvilluar aktivitete sportive mbas orarit të rregullt mësimor dhe në ditët e pushimit nga ana e personave fizikë/ juridikë të licensuar nga Federatat e sportit përkatës, ky i fundit i përzgjedhur nga ana e Bashkisë.

Neni 2 Kudri ligjor

Kjo marrëveshje mbështetet në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë, ligjin 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit 69/2012, “Për arsimin parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjit 79/2017 “Për Sportin” i ndryshuar, VKB 89, datë 26.07.2021 “Për një ndryshim në VKB Nr.127, datë 24.12.2020 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Durrësit për vitin 2021” në lidhje me dhënie në përdorim të palestrave të shkollave të arsimit 9 vjeçar dhe të mesëm për zhvillimin e aktiviteteve sportive pas programit mësimor dhe në ditët e pushimit.

Neni 3 Përmbajtja e projektit

Projekti “Shkolla Qendër Komunitare” përmban:

- Promovimin dhe implementimin e sporteve si një mundësi edukimi fizik dhe argëtimi për fëmijët e shkollave të arsimit 9 vjeçar dhe të mesëm;
- Ndihmesën në forcimin e shëndetit, zhvillimin e cilësive fizike, shprehive motorike e koordinative si dhe rritjen e vlerave shoqërore të fëmijëve duke u angazhuar në veprimtari sportive;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DREJTORIA ARSIM, KULTURË, RINI
SPORT, KOMUNITETE FETARE
SEKTORI I SPORTEVE

- Formimi i fëmijëve në aspektin fizik dhe mendor si mjet për të luftuar sedentarizmin dhe për të shmangur çdo formë të shfaqjeve negative të kohës, obezitetin dhe nxitjen e miqësisë midis të rinjve duke u përfshirë në aktivitete sportive;
- Mundësimi i stërvitjeve dhe garave sportive të këtij sporti në dobi të shëndetit dhe zhvillimit të aftësive motorike dhe në shërbim të cilësisë së jetës;
- Rritja e interesit të fëmijëve për ushtrimin e sporteve, forcimin e personalitetit të fëmijëve;
- Krijimi i traditës së shkollës si qendër komunitare dhe përmirësimi i infrastrukturës sportive;
- Promovimi i imazhit të shkollës si qendër komunitare dhe evidentimi i nxënësve të talentuar;
- Rritja e interesimit të komunitetit të prindërve për sportin;
- Mirëadministrimi i hapësirave sportive në qytetin e Durrësit.

Neni 4
Të drejtat dhe detyrimet e palëve

Bashkia Durrës

- Merr përsipër angazhimin për të promovuar nismën e projektit “Shkolla Qendër Komunitare”.
- Informon nëpërmjet faqes së saj web:ww.durres.gov.al mbi projektin “Shkolla Qendër Komunitare”.
- Të presë dhe të shqyrtojë të gjitha kërkesat të cilat vijnë nga personat fizik/juridik me paanshmëri.
- Të vlerësojë dhe të monitorojë nëpërmjet konkursit të zhvilluar nga komisionet e ngritura për këtë qëllim, projektet që vijnë nga personat fizik/juridik të licensuar nga Federatat e sportit përkatës.
- Merr përsipër të vendosë në dispozicion të personave fizik/juridik të shpallur fitues pas procedurës së konkurimit ambjentet sportive të Shkollës, duke përcaktuar oraret mes tyre, pa cënuar realizimin e programit mësimor dhe aktivitetet e saj, të cilat kanë prioritet.

Personat fizik/juridik

- Personat Fizik/Juridik duhet të sigurojnë kompetencë profesionale në realizimin e projektit në mënyrë sa më të përgjegjshme.
- të vendosë ne websit-in zyrtar informacion mbi ecurinë e projektit dhe kohëzgjatjen e tij.
- të respektojë realizimin e programit mësimor të shkollës duke mos e cënuar atë dhe të ndërpresë aktivitetin e tij sportiv në ato raste kur shkolla parashikon zhvillimin e një aktiviteti.
- të respektojë kuadrin ligjor në fuqi për përdorimin e ambjenteve sportive të shkollës të vëna në dispozicion për zhvillimin e projektit si dhe të garantojë mirëmbajtjen e tij.
- hartimin e procesverbalit të konstatimit mbi gjendjen aktuale të ambjentit sportiv, paisjet dhe kushtet me përfaqësuesin e drejtorisë së shkollës, i ngarkuar për këtë qëllim. Ky procesverbal është pjesë përbërëse e dokumentacionit dhe një kopje e protokolluar dorëzohet pranë Drejtorisë së Arsim, Kulturë, Rini, Sporte dhe Komunitete Fetare, Bashkia Durrës.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DREJTORIA ARSIM, KULTURË, RINI
SPORT, KOMUNITETE FETARE
SEKTORI I SPORTEVE

- në raste të dëmtimeve të ambjenteve sportive apo të çdo ambjenti tjetër të shkollës gjatë orarit të zhvillimit të aktivitetit sportiv nga personat fizik/juridik detyrohet të riparojë dëmin apo të dëmshpërblejë shkollën për dëmin e shkaktuar.
- Në rastin e konstatimit nga ana e DAKRSKF apo Drejtorisë së shkollës të ndonjë dëmi eventual të shkaktuar ambjentit sportiv të marrë në përdorim, personat fizikë/juridikë detyrohen të rikthejnë ambjentin në gjendjen e mëparshme ose të paguajnë vlerën financiare të këtij dëmtimi.
- të hartojë një program për aktivitetin sportiv që do të zhvillojë në palestrat ose ambjentet sportive të shkollës përgjatë vitit akademik.
- të zhvillojë aktivitete sportive ku të përfshihen të gjitha grupmoshat e nxënësve si dhe të organizojë gara sportive midis tyre.
- të mbështesë integrimin në aktivitete sportive pa pagesë të fëmijëve dhe të rinjve të cilët vijnë nga grupe sociale vulnerabël (fëmijët nga familje në nevojë, jetimë, ndihmë ekonomike etj.)
- të angazhohet që 2 ditë në javë, kryesisht në fundjavë të ofrojë aktivitete sportive pa pagesë në shërbim të komunitetit.
- t'i përmbahet projektit paraprak të dorëzuar në momentin e aplikimit, në lidhje me përdorimin dhe shfrytëzimin e palestrave ose ambjenteve sportive të shkollave, në të cilin është përcaktuar edhe programi dhe orët që këto palestra ose ambjente sportive do të vendosen në shërbim të komunitetit.
- të derdhë në llogarinë e Qendrës Ekonomike të Arsimit çdo muaj, brenda datës 5 të çdo muaji.
- detyrimet e konsumit të energjisë elektrike do të përllogariten në momentin e lidhjes së kontratës.

Shkolla

- të hartojë një procesverbal dorëzimi me personat fizik/juridik mbi gjendjen aktuale të ambjentit, pajisjet dhe kushtet e tij;
- të ofrojë dhe të garantojë bashkëpunimin e saj në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi për realizimin e projektit “Shkolla Qendër Komunitare”;
- të mbledhë informacion si foto, video etj., me qëllim që të publikohen në faqen zyrtare të saj, shoqëruar më logon e Bashkisë Durrës;
- të marrë pjesë në çdo takim që do të organizohet ndërmjet palëve për të diskutuar mbi ecurinë e projektit.

Neni 5

Tarifa

Personat Fizik/Juridik detyrohet të paguajë pranë Qendrës Ekonomike të Arsimit shumën prej 200 lekë çdo orë, sipas tarifës së përcaktuar në Vendimin nr. 89, datë 26.07.2021 të Këshillit Bashkiak “Për një ndryshim në VKB Nr.127, datë 24.12.2020 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Durrësit për vitin 2021 në lidhje me dhënien në përdorim të palestrave të shkollave të arsimit 9 vjeçar dhe të mesme për zhvillimin e aktiviteteve sportive pas programit mësimor dhe në ditët e pushimit”.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DREJTORIA ARSIM, KULTURË, RINI
SPORT, KOMUNITETE FETARE
SEKTORI I SPORTEVE

Neni 6
Kohëzgjatja e marrëveshjes

Kohëzgjatja e marrëveshjes do të jetë për një periudhë prej 12 muajsh, duke filluar nga data e nënshkrimit të saj nga palët.

Neni 7
Zgjidhja e marrëveshjes

Në rast mosmarrëveshje, palët duhet t'i zgjidhin me mirëkuptim, në të kundërt kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës. Vendimet e saj, palët marrin përsipër t'i respektojnë.

Secila nga palët mund të njoftojë palët e tjera për zgjidhjen e kësaj marrëveshje duke i njoftuar ato të paktën 1 muaj përpara.



Neni 8
Njoftimet midis palëve

Për çdo njoftim ose komunikim tjetër të kërkuar, palët do t'i drejtohen njëra-tjetrës në adresat e zyrtare në formë shkresore.

Neni 9
Të ndryshme

Kjo marrëveshje e shkruar përbën marrëveshjen e plotë midis palëve. Marrëveshjet verbale dhe parashikimet e bëra gjatë bisedimeve për lidhjen e kësaj marrëveshje nuk përbëjnë kushte të kësaj marrëveshje. Çdo ndryshim i kushteve të kësaj marrëveshjeje do të jetë i vlefshëm vetëm pasi të jetë bërë më shkrim dhe nënshkruar nga të dyja palët.

Kjo marrëveshje hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit të palëve.

Shkolla "....."
Përfaqësuar nga

Personi Fizik/Juridik

KRYETAR
Emiriana Sako



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 939/prot.
2

Durrës, më 06.12.2021

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS



Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.147 datë 25.11.2021 “Për miratimin e përdorimit kundrejt tarifës të palestrave të shkollave të arsimit 9 vjeçar dhe të mesëm për zhvillimin e aktiviteteve sportive pas programit mësimor dhe në ditët e pushimit.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

ROLAND NASTO

